

**AKT THEMELI
MI I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR
“ERN PARTNERS” Limited Company shpk.**

Në Tiranë, sot më datë 07.12.2022, une i poshteshënuari:

Ibrahim Hatipoglu , i datëlindjes 18.01.1990, lindur ne Kadikoy,Turqi,identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër U21870349.

me cilësinë e “ortakut themelues”deklaroj se me vullnet të lirë të plotë, mbështetur në ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008, “ Për tregtarët dhe shoqërítë tregtare ” i ndryshuar, ligjin Nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Regjistrimin e Biznesit”, i ndryshuar, krijoj shoqerinë tregtare me përgjegjësi të kufizuar, **“ERN PARTNERS” Limited Company shpk.**

**Neni 1
Emri, Forma**

Shoqëria do të ketë emrin **“ERN PARTNERS” Limited Company shpk**, dhe formë ligjore: “Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” e quajtur më poshtë “Shoqëria”.

**Neni 2
Personaliteti juridik**

Shoqëria fiton personalitetin juridik, pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligji.

**Neni 3
Selia**

Shoqëria **“ERN PARTNERS” Limited Company shpk** e ka seline në adresë:
“Ruga Muhamet Gjollesha Nr 5 Zona kadastrale 8250 Volumi 3 faqe 5, Tirane”dhe mund ta ndryshojë atë me vendim të asamblesë së ortakëve.

**Neni 4
Objekti i veprimtarisë**


Objekti i ushtrimit të veprimtarise per shoqërime **“ERN PARTNERS” Limited Company shpk** është “Shitje software,marketing online,agjensi udhetimi dhe konsultime biznesi”

**Neni 5
Kohëzgjatja**

Shoqëria do të zhvilloje aktivitetin e saj pa afat.

**Neni 6
Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i nënshkruar dhe i shlyer i shoqërise është 100,000 lekë, i ndarë në 1(një) kuote e cila zotërohet si më poshtë:



Ibrahim Hatipoglu , i datëlindjes 18.01.1990, lindur ne Kadikoy,Turqi,identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër U21870349,zoteron 1(nje) kuote qe perkon me 100% te kapitalit te shoqerise.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë ,pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta. Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te saj ne Qendren Kombetare të Biznesit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

Neni 8

Organi Vendimmarrës

Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë, për çështjet e meposhtme

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundershtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të



qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

**Neni 9
Administrimi**

Administrator i shoqërisë **"ERN PARTNERS" Limited Company shpk** është: Ibrahim Hatipoglu , i datëlindjes 18.01.1990, lindur ne Kadikoy,Turqi,identifikuar me dokument identifikimi:pasaporte me numër U21870349. Administratori i shoqërisë është i emëruar për një afat 5(pesë) vjeçar.Data e emërimit te tij përkon me datën e themelimit te shoqerisë qe eshte data 07.12.2022.

**Neni 10
Baza Ligjore**


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.Për sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik në Republiken e Shqipërisë.

**Neni 11
Dispozita perfundimtare**

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopje, në gjuhën shqipe, me përbajtje dhe vlera te njëjtë juridike.Akti i mësimperm pasi miratohet në parim dhe nen per nen nga ortakët themelues të shoqërisë tregtare **"ERN PARTNERS" Limited Company shpk**, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen orgjinale.

ORTAKU THEMELUES:

Ibrahim Hatipoglu



Tiranë, më datë 07.12.2022

